



DITARI MUJOR

SHKURT 2022

SKEMA KOMBËTARE

Nis zbatimin e Skemës Kombëtare 2022 në mbështetje të bujqësisë, me fondin 3.2 miliardë lekë, fondi më i madh i alokuar që nga viti 1991.

Fokusi te përmirësimi dhe rritja e përthithjes së Skemës Mbështetëse me naftë për punime të mekanizuara që ulin kostot e prodhimit; ndërtimi i serrave diellore për shtimin e sipërfaqeve të reja, mbështetja për fara e fidanë të certifikuar duke rritur gjurmueshmërinë, sigurinë ushqimore dhe duke ulur kostot e prodhimit; certifikimi organik dhe Global GAP si dhe zgjerimi i sipërfaqes së mbjellë me bimë medicinale duke zgjeruar potencialet eksportuese; mbështetja për zgjerim të blegtorisë dhe bletarisë; zgjerimi i tregjeve bujqësore që bashkojnë fermerët në shitje, në bashkëpunim me pushtetin vendor; mbështetje për inovacion dhe digjitalizim në ferma; ngritja e Skemës Kombëtare të Informimit në bujqësi, blegtori dhe peshkim në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës duke krijuar dhe qendrën e ekselencës dhe inovacionit të sistemeve prodhuese; fuqizimi i sektorit të peshkimit duke rinovuar anijet, infrastrukturën e peshkimit dhe duke zgjeruar kapacitetet eksportuese.

Aplikimet, që në ditët e para, kanë qenë në masë rekord, duke pasqyruar rritje të besueshmërisë së fermerit. Qytetarët kanë në dispozicion 79 pika aplikimi përfshirë zyrat Adisa, QTTB-të dhe AREB-et në të gjithë vendin.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në linkun: <https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Udhezim-nr.1-dt.11.2.2022-Skemat-Kombetare.pdf>



DIALOG ME MINISTREN

Për një politikëbërje përfshirëse



Ministria Frida Krifca ka nisur një platformë dialogu të përmuajshme, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, ku do të trajtojnë një temë të përzgjedhur bashkërisht me profesorë, studentë, fermerë e grupe interesi. Në takimin e parë në UBT, në fillim në muajt, u diskutua Skema Kombëtare në prani të akademikëve dhe fermerëve nga Baldushku, Farka, Mulleti, Petrela, Lundra, Laknasi, Krraba e Kashari. Qasja e ministres Krifca është për një politikëbërje përfshirëse më të mirë, në shërbim të zhvillimit. Nëse dëshironi të trajtoni një temë diskutimi të posaçme, na shkruani në dialogmeministren@bujqesia.gov.al.



FËMIJËT NË BUJQËSI

Si vjen mjalti deri në tryezën tonë?

Fëmijët e kopshtit nr.31, "Simba", në kryeqytet, mësuhan se si vjen mjalti në tryezën tonë. Deri tani, ata kanë parë se mjalti vjen nga supermarketet. Bletari Besim Madhi nga Petrela, u mësoi se sa shumë punojnë bletët për të prodhuar mjaltin, si krijohen hojjet, u tregoi një kornizë hojesh të nënës Mbretëreshë dhe shpjegoi pse duhet të kujdesemi për natyrën, në mënyrë që të kemi ushqime sa më të shëndetshme në tavolinë. Besimi e ka të trashëguar profesionin e tij, është rritur mes bletësh. Ka mbaruar shkollën veterinare dhe tashmë ka fermën e tij me 65 koshere.

OPEN BALKAN



Krijohen hapësirat inspektuese për lehtësimin e eksportit.

Në kuadër të marrëveshjes "Open Balkan", është arritur dakordësim mes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit mbi hapësirat inspektuese të AKU-së, për lehtësimin e eksportit vendas dhe importin me vendet e kësaj iniciative.

Janë trajnuar inspektorët e terrenit dhe ata të pikave të inspektimit kufitar të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në mënyrë që të nisë sa më shpejt informimi i operatorëve të biznesit ushqimor që do të përfshihen nga nisma për Ballkanin e Hapur.

SIGURIA USHQIMORE



AKU me rregullore të re, sipas rasteve europiane alerte.

AKU ka rifreskuar rregulloren për ndjekjen e rasteve europiane alerte të ushqimeve mbi normën e lejuar, në mënyrë edhe më eficiente dhe me cikël të mbyllur raportimi, si për vendin tonë, ashtu dhe për Komisionin Europian. Pesë raste janë trajtuar gjatë muajit shkurt dhe janë gjurmuar deri në finalizimin e raportimit, duke siguruar konsumatorin vendas dhe zinxhirin ushqimor europian. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer mbi 7700 inspektime dhe riverifikim të profilizimit të riskut për çdo operator biznesi ushqimor.

TË RINJTË DHE INOVACIONI



URBAN FARMING, krijohet shkolla e parë urbane bujqësore.

Krijohet shkolla e parë urbane bujqësore në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Projekti ka qëllim të pajisë të rinjtë me aftësi bujqësore në zonat urbane, si tarraca e ballkone. Janë regjistruar rreth 100 studentë për klasat që do të nisin këtë projekt arsimor joformal nëpërmjet SRD, (Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural) i implementuar nga GIZ, në bashkëpunim me Qendrën Kulturorë Tulla. Të rinjtë do të marrin dije që nga gjetja e farave e deri tek rritja e bimëve në kushte urbane.



info@bujqesia.gov.al
frida.krifca@bujqesia.gov.al



@mbzhr_al
@frida.krifca



@MinistriaeBujqesisedheZhvillimitRural
@fridakrifca1